



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), nenin 4, paragrafi 3 si dhe nenin 81 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit nr.05/L-045 për sigurimet, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.38/24 dhjetor 2015) Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 28 prill 2016, miratoi si vijon:

## **RREGULLORE PËR AUDITIMIN E JASHTËM TË SIGURUESVE, NDËRMJETËSUEVE TË SIGURIMEVE, TRAJTUESVE TË DËMEVE DHE BYROSË KOSOVARE TË SIGURIMIT**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Me këtë Rregullore BQK-ja rregullon çështjen e aprovimit të auditorëve të jashtëm, të cilat kryejnë auditim të jashtëm të siguresve, ndërmjetësuesve të sigurimeve, trajtuesve të dëmeve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit, të licencuara, mbikëqyrura dhe të rregulluara nga BQK-ja. Po ashtu me këtë Rregullore BQK-ja përcakton kërkesat lidhur me kryerjen e auditimeve të jashtme, rregullon çështjen e angazhimit të tyre si dhe mban regjistrin e auditorëve të jashtëm në kryerjen e auditimeve të jashtme të subjekteve lartcekura të sigurimeve.
2. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të forcojë kornizën rregullatore që ka të bëjë me auditorët e jashtëm të siguresve, ndërmjetësuesve të sigurimeve, trajtuesve të dëmeve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit dhe të përcaktojë kualitetin e shërbimeve të ofruara nga auditorët e jashtëm, në raport me rreziqet specifike në sigurime dhe të sektorit financiar në përgjithësi.
3. Kjo Rregullore aplikohet për siguresit, përfshirë degët e siguresve të jashtëm, ndërmjetësuesit e sigurimeve, trajtuesit e dëmeve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimeve, të licencuara nga BQK-ja për të ushtruar aktivitete përkatëse të sigurimeve dhe të cilat mbikëqyren dhe rregullohen nga BQK-ja.

### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin të njëjtë siç janë përcaktuar në nenin 3 të Ligjit nr. 05/L-045 për sigurimet (me tutje: Ligji për sigurimet) dhe /ose siç përcaktohet me poshtë për qëllimet e kësaj Rregulloreje:
  - a) “*Auditim i jashtëm*” nënkupton auditim të llogarive vjetore apo llogarive të konsoliduara, në pajtim me legjislacionin për sigurime në Kosovë.
  - b) “*Auditor i jashtëm*” nënkupton vetëm firmën e auditimit.
  - c) “*Firmë auditimi*”- nënkupton një person juridik ose çfarëdo entiteti tjetër, pa marrë parasysh formën ligjore, që është e licencuar në përputhshmëri me Ligjin në fuqi për

- kontabilitet, raportim financiar dhe auditim (në vijim: Ligji për raportim financiar) për të kryer punët e auditimit.
- d) "*Auditor i jashtëm i emëruar*" nënkupton auditorin e jashtëm i emëruar nga një sigurues, ndërmjetësues i sigurimeve apo Byroja Kosovare e Sigurimit, për të kryer shërbime të auditimit dhe për të siguruar raport dhe opinion për gjendjen financiare, raport përmbledhës të kontrolleve të brendshme, raport mbi ekspozimin e rrezikut, ekspozimet financiare dhe letrat e punës.
  - e) "*Auditor i jashtëm i kualifikuar*" nënkupton anëtarin e licencuar nga Këshilli Kosovar për Raportim Financiar (KKRF) dhe që është anëtar i një shoqate profesionale të kontabilistëve dhe auditorëve të Kosovës ose jashtë saj, i kualifikuar, i aprovuar nga BQK-ja për të kryer auditimin e jashtëm dhe kompetent për të firmosur opinionin e gjendjes financiare të raporteve të audituara të klientëve në sigurime.
  - f) "*Pasqyra financiare*" nënkupton pasqyrën e gjendjes financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet plotësuese dhe materialet sqaruese, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.
  - g) "Sigurues" nënkupton personin juridik i licencuar për të ushtruar veprimtari të sigurimeve sipas përcaktimeve të ligjit të sigurimeve.
  - h) "*Ri sigurues*" nënkupton personin juridik i licencuar për të ushtruar veprimtari risigurimi sipas përcaktimeve të Ligjit të sigurimeve.
  - i) "*Ndërmjetësues i Sigurimeve*" nënkupton, personat juridik të licencuar nga BQK-ja si kompani të agjentëve në sigurime dhe kompani të brokerimit në sigurime, për të kryer aktivitete të ndërmjetësimit në sigurime.
  - j) "*Trajtues i dëmeve*" nënkupton persona juridik të licencuar nga BQK-ja dhe të kontraktuar nga të siguruarit apo siguruesit, për të kryer aktivitete të vlerësimit të dëmeve.
  - k) "*Sigurues i jashtëm*" nënkupton degën e siguruesit të jashtëm, e cila ka selinë kryesore në ndonjë vend të jashtëm dhe është licencuar për të ushtruar aktivitete sigurues në Republikën e Kosovës përmes degës.
2. Kudo që në këtë Rregullore përdoret termi sigurues, nënkuptohet edhe risiguruesi dhe kudo që përdoret termi ndërmjetësues i sigurimeve kuptohet edhe ndërmjetësues i risigurimeve.

### **Neni 3**

#### **Kushtet dhe kërkesat për aprovim të auditorëve të jashtëm nga BQK-ja**

1. Auditori i jashtëm i një siguruesi, ndërmjetësuesi të sigurimeve, trajtuesi të dëmeve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit, duhet të aprovohet nga BQK-ja.
2. Në bazë të kërkesës së parashtruar me shkrim, BQK-ja mund të japë miratimin për auditor të jashtëm të një siguruesi, ndërmjetësuesi të sigurimeve, trajtuesi të dëmeve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit, vetëm për:
  - a) Një auditor të jashtëm të licencuar në Republikën e Kosovës në pajtim me Ligjin për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim;
  - b) Auditorët e firmës së auditimit, të licencuar në Republikën e Kosovës në pajtim me Ligjin për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim që mbajnë anëtarësinë e rregullt në një shoqatë profesionale të kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë, në pajtim me Ligjin për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim;

3. Një auditor të huaj apo një firmë të huaj të auditimit duhet, i cili të jetë i licencuar sipas Ligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim. Auditori i huaj apo firma e huaj e auditimit duhet të veproj në pajtueshmëri me Ligjin për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim dhe kërkesat e parapara me Udhëzimet e KKRF-së për licencim.
4. BQK-ja do të aprovojë si auditor të jashtëm të një siguruesi, ndërmjetësuesi të sigurimeve, trajtuesi të dëmeve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit, auditorin e jashtëm që ka reputacion të mirë dhe që nuk është i angazhuar në asnjë aktivitet, i cili është në mospërputhshmëri me funksionet e auditimit të jashtëm.

#### **Neni 4**

##### **Kushtet specifike dhe kërkesat**

1. Stafi i auditorit të jashtëm për të mbajtur pozitat e tyre respektive si auditor të jashtëm të një siguruesi, ndërmjetësuesi të sigurimeve, trajtuesit të dëmeve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit, duhet të plotësoj të gjitha kërkesat në vijim, që të:
  - a) jenë të përshtatshëm dhe të duhur;
  - b) kenë integritet, ndershmëri dhe përkushtim për përmbushjen e detyrave të tyre;
  - c) kenë kompetencë, aftësi profesionale dhe gjykim të shëndoshë në përmbushjen e detyrave të tyre;
  - d) jenë të pavarur në mënyrë që të mos ndikojë negativisht në interesat e siguruesit apo konfliktit të interesit që mund të lind gjatë kohës së kryerjes së detyrës;
  - e) kenë kualifikimet profesionale të përcaktuara, të dëshmuara me një diplomë ose certifikatë të lëshuar nga një universitet ose një organizatë e njohur profesionale që vërteton përfundimin e suksesshëm të ciklit të plotë të kualifikimeve për auditor të jashtëm;
  - f) jetë anëtar i një shoqate apo organizate profesionale të kontabilitetit dhe auditimit dhe që plotëson kërkesat për licencë në përputhshmëri me Ligjin për raportim financiar;
  - g) një auditor të jashtëm që ka së paku 3 (tre) vjet eksperiencë në, fushën e auditimit të pasqyrave financiare të siguruesve apo institucioneve të tjera financiare apo stafi pjesëmarrës i të cilit kryen auditimin, të ketë një eksperiencë të tillë.
  - h) posedoj dhe zotëroj njohuri profesionale të legjislacionit, njohuri të etikës dhe të praktikave më të mira për sigurime;
  - i) përveç dispozitave të cekura më lartë, BQK-ja vlerëson sjelljen e mëhershme dhe aktivitetet e personit në fjalë, në biznesin ose çështje financiare dhe në veçanti, shqyrton nëse ka prova për të treguar se ky person ka qenë apo është:
    - i. i dënuar brenda 10 viteve të fundit për ndonjë vepër penale;
    - ii. i përfshirë ose i lidhur me ndonjë humbje financiare të shkaktuar nga veprimet e pandershme, të pamatura ose të pakujdesshme në lidhje me kryerjen e shërbimeve financiare dhe menaxhimin e kompanive të tjera;
    - iii. i angazhuar në praktika jo të mira tregtare të biznesit duke përfshirë evazionin fiskal, të cilat BQK-ja i konsideron praktika mashtruese, të papërshtatshme ose kërcënuese, të cilat në një mënyrë pasqyrojnë mangësi të vlerave të një personi për të kryer shërbime financiare dhe operacione të tjera të biznesit;
    - iv. apo nuk ka përmbushur, ka vonuar ose nuk ka paguar tatimin apo detyrime të tjera qeveritare.

2. Aplikacioni për aprovim duhet të përmbajë:
  - a) programin e auditimit të siguruesit;
  - b) përshkrimin e shfrytëzimit të burimeve gjatë shërbimit të auditimit;
  - c) letrën e angazhimit të auditorit të jashtëm ose kontratën e shërbimit të ofruar;
  - d) dokumentin që vërteton përvojën e mjaftueshme të auditorit të jashtëm apo të stafit të tij i cili kryen auditimin në fushën e auditimit të sigurimeve; apo institucioneve të tjera financiare;
  - e) vërtetimin e lëshuar nga KKRF-ja në lidhje me rezultatet e kontrollit të fundit të cilësisë për auditorin e jashtëm (në qoftë se KKRF-ja nuk lëshon një vërtetim të tillë, i njëjti nuk do të kërkohet nga BQK-ja);
  - f) programi i auditimit dhe shfrytëzimi i burimeve gjatë shërbimit të auditimit, duhet të jetë i përshtatshëm në raport me karakterin dhe madhësinë e siguruesit.
3. BQK-ja, aprovon vetëm për një vit auditorin e jashtëm apo firmën e auditimit, aprovimi është i kufizuar për një institucion specifik të sigurimeve si: siguruesi, ndërmjetësuesi i sigurimeve, trajtuesi i dëmeve apo Byroja Kosovare e Sigurimit.
4. Asnjë auditor i jashtëm nuk mund të angazhohet në auditimin e jashtëm të një siguruesi, ndërmjetësuesi të sigurimeve, trajtuesi të dëmeve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit, për më gjatë se pesë (5) vite të njëpasnjëshme, ndërsa mund të rimarrë pjesë në auditimin e të njëjtit sigurues pas mbarimit të afatit kohor prej të paktën dy (2) vite.

## **Neni 5**

### **Emërimi i auditorëve të jashtëm**

Auditori i jashtëm duhet të emërohet çdo vit nga mbledhja e përgjithshme e aksionarëve apo anëtarëve të entitetit të audituar. Siguruesi, ndërmjetësuesi i sigurimeve, trajtuesi i dëmeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve, është i detyruar të njoftojë BQK-në me shkrim lidhur me emërimin e auditorit të jashtëm dhe të dorëzojë aplikacionin për aprovim jo më vonë se data 30 korrik të secilit vit.

## **Neni 6**

### **Regjistri i auditorëve të jashtëm të aprovuar të sigurimeve**

BQK-ja duhet të mirëmbajë në faqen e saj të internetit regjistrin për secilin auditor të jashtëm të aprovuar për të kryer auditim në institucionet e sigurimeve në Kosovë. Regjistri duhet të përmbajë informacione të përgjithshme për auditorin e jashtëm.

## **Neni 7**

### **Riauditimi**

BQK-ja ka të drejtë të kërkojë ribërjen e auditimit nga një tjetër auditor i jashtëm me shpenzimet e siguruesit, në rastet kur auditori i jashtëm ekzistues i siguruesit e ka kryer auditimin ose ka paraqitur një raport, i cili nuk është në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), kërkesat e Ligjit për sigurime, rregulloret e BQK-së, apo nuk shpreh gjendjen financiare të vërtetë dhe të saktë të siguruesit.

## **Neni 8**

### **Etika profesionale**

1. Auditorët e jashtëm duhet t'i nënshtrohen parimeve të etikës profesionale të përcaktuara nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve "Kodi i etikës për Kontabilistët Profesional".
2. Auditorët e jashtëm do t'i nënshtrohen parimeve të etikës profesionale të cilat mbulojnë përgjegjësinë e auditorëve të jashtëm ndaj publikut, integritetin dhe objektivitetin e tyre, kompetencën e tyre profesionale dhe kujdesin e duhur.

## **Neni 9**

### **Pavarësia dhe objektiviteti**

1. Gjatë kryerjes së auditimit, auditorët e jashtëm duhet të jenë të pavarur nga entiteti që auditohet dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të përfshihen në vendimet e menaxhmentit të siguresit që auditohet. Auditorët e jashtëm nuk duhet të kryejnë auditimin nëse ekziston ndonjë marrëdhënie direkte apo indirekte financiare, pune, punësimi apo çfarëdo marrëdhënie tjetër, përfshirë edhe provizionin për shërbimet joaudituese shtesë ndërmjet auditorëve të jashtëm dhe siguresit që auditohet, nga e cila një palë e tretë objektive e arsyeshme dhe e informuar do të mund të konkludonte se pavarësia e auditorëve të jashtëm është kompromentuar.
2. Auditorët e jashtëm duhet të dokumentojnë në letrat e punës së auditimit të gjitha kërcënimet e pavarësisë së tyre si dhe masat e sigurisë që i kanë ndërmarrë për zbutjen e atyre kërcënimeve.

## **Neni 10**

### **Pavarësia dhe objektiviteti i auditorëve të cilët kryejnë auditim në emër të firmave audituese**

Pronarët apo aksionarët e një firme audituese të aprovuar, gjithashtu edhe anëtarët e organeve administrative, menaxhuese dhe mbikëqyrëse të asaj firme apo të një firme të lidhur, nuk duhet të ndërhyjnë në ekzekutimin e ndonjë auditimi në çfarëdo mënyre që do të rrezikonte pavarësinë dhe objektivitetin e auditorit i cili kryen auditimin në emër të firmës audituese.

## **Neni 11**

### **Konfidencialiteti dhe sekreti profesional**

1. Auditorët e jashtëm dhe bashkëpunëtorët e auditorëve të jashtëm, kanë për detyrë të ruajnë konfidencialitetin sa i përket çfarëdo njohurie të përfituar gjatë kohës së aktiviteteve të tyre, përveç nëse me ligj përcaktohet ndryshe apo në rastet kur informata ka të bëjë me personin, detyra e të cilit nuk kërkon fshehtësinë profesionale. Auditorët e jashtëm dhe bashkëpunëtorët e auditorëve të jashtëm nuk mund t'i shfrytëzojnë ato informata për aktivitetet e veta për shërbim apo punësim të tjerëve.
2. Auditorët e jashtëm, pa marrë parasysh kufizimet e paraqitura në paragrafin 1 të këtij neni apo të marrëveshjes për konfidencialitet, mund të japin shpjegime dhe paraqesin dokumentacionin rreth auditimit të kryer, në rastet kur kërkohet me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
3. Kur një auditor i jashtëm apo firma e auditimit është zëvendësuar nga një auditor i jashtëm apo firmë e auditimit tjetër, auditori i jashtëm apo firma e auditimit të mëparshëm duhet t'i ofrojë

auditorit të jashtëm apo firmës së auditimit të tanishme, qasje në të gjitha informatat e rëndësishme lidhur me entitetin i cili auditohet.

4. Detyrimi i mbajtjes së konfidencialitetit i një auditori të jashtëm apo firmës së auditimit vazhdon të zbatohet edhe pasi të ketë përfunduar angazhimi i tij te një sigurues.

## **Neni 12**

### **Fushëveprimi i auditimit**

1. Auditorët e jashtëm duhet të vlerësojnë nëse llogaritë vjetore të siguruesit janë apo nuk janë përgatitur dhe finalizuar në pajtim me Standardet Ndërkombëtare për Raportim Financiar (SNRF), me Ligjin për sigurime dhe rregulloret e BQK-së, të vlerësojë nëse menaxhmenti i siguruesit ka përmbushur apo jo obligimin e tij për të siguruar shënime të sakta dhe të duhura, si dhe të vlerësojë se a është bërë dokumentimi i informatave kontabël në pajtim me standardet, ligjin dhe rregulloret e lartcekura.
2. Auditorët e jashtëm duhet të vlerësojnë nëse informatat në raportet vjetore lidhur me llogaritë vjetore, supozimet lidhur me vazhdimësinë e operacioneve dhe propozimet në lidhje me shfrytëzimin e tepricave (fitimeve) apo mbulimin e humbjeve janë në pajtim me Ligjin për sigurimet dhe rregulloret e BQK-së.
3. Auditorët e jashtëm duhet të vlerësojnë mjaftueshmërinë e sistemeve të administrimit të rreziqeve të siguruesit, duke u bazuar në vlerësimin e:
  - a) Përputhshmërisë me kërkesat e strukturës organizative për administrimin e çdo rreziku specifik;
  - b) Politikave dhe procedurave për administrimin e çdo rreziku specifik si dhe të zbatimit të tyre;
  - c) Mjaftueshmërisë së identifikimit, matjes dhe monitorimit të çdo rreziku specifik;
  - d) Mjaftueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit të auditimit të brendshëm në lidhje me administrimin e çdo rreziku specifik.
4. Rreziqet specifike përfshijnë: rrezikun e likuiditetit, rrezikun e vetvetishëm, rrezikun e tregut, rrezikun operacional dhe rreziqet e tjera ndaj të cilave siguruesi ekspozohet.
5. Auditorët e jashtëm duhet të kryejnë një vlerësim për siguruesit lidhur me mënyrën e menaxhimit të mjeteve dhe vendosjen e kontrolleve të brendshme të duhura.
6. Auditimi i siguruesve duhet të mbulojë të gjitha fushat e veprimtarisë së siguruesit: portofolin e sigurimeve, vlerësimin e mjeteve dhe mjaftueshmërinë e tyre, provizionet teknike të cilat duhet të jenë të mjaftueshme për të mbuluar përgjegjësitë e nënshkruara dhe humbjet nga rreziqet që rrjedhin nga kontratat e sigurimit, provizionet teknike për primin e pafituar, provizionet për rezervat për bruto dëmet, siç është përkrahur në nenin 67 të Ligjit për sigurimet, si dhe të japë opinionin e tij lidhur me mjaftueshmërinë apo pa mjaftueshmërinë e tyre të kalkuluar nga aktuari i siguruesit.
7. Auditimi po ashtu duhet të mbulojë funksionimin dhe mjaftueshmërinë e kontrolleve të brendshme si dhe funksionimin e sistemeve të menaxhmentit.

8. Auditorët e jashtëm duhet që nëpërmes auditimeve të kontribuojnë në parandalimin dhe shpалosjen e parregullsive dhe gabimeve.

### **Neni 13**

#### **Detyrat e auditorëve të jashtëm**

1. Auditorët e jashtëm duhet të kryejnë auditimet sipas gjykimit të tyre më të mirë, përfshirë vlerësimin e rrezikut nga përfshirja e informatave të gabuara në llogaritë vjetore për shkak të parregullsive dhe gabimeve.
2. Auditorët e jashtëm duhet të sigurojnë se kanë bazë të mjaftueshme për të vlerësuar nëse është bërë ndonjë shkelje e Ligjit për Sigurimet dhe Rregulloreve të BQK-së, të cilat janë materiale sa i përket llogarive vjetore.
3. Auditorët e jashtëm duhet të kontrollojnë rregullshmërinë, saktësinë dhe të konstatojnë se raportimet e siguruesve të paraqitura në BQK janë të plota dhe në përputhje me kërkesat rregullative në fuqi të miratuara nga BQK-ja. Bazuar në kontrollin e ushtruar, auditorët e jashtëm duhet të vlerësojnë nëse raportimet janë kryer ose janë në përputhje me Ligjin për sigurimet dhe rregulloret e BQK-së dhe nëse ato pasqyrojnë në mënyrë të drejtë dhe objektive gjendjen financiare të siguruesit.
4. Auditorët e jashtëm duhet t'ia paraqesin me shkrim bordit të drejtorëve të siguruesve rrethanat e poshtëshënuara:
  - a) Mangësitë në lidhje me detyrimin për të siguruar regjistrimin e duhur, shpалosjen e qartë dhe dokumentimin e informatave kontabël;
  - b) Gabimet dhe mangësitë në organizimin dhe kontrollin e menaxhimit të mjeteve;
  - c) Parregullsitë dhe gabimet që mund të shkaktojnë informim të gabuar në llogaritë vjetore;
  - d) Rrethanat që mund të shkaktojnë detyrime të anëtarëve të bordit të drejtorëve, asamblesë së përgjithshme të aksionarëve apo menaxhmentit të lartë.

### **Neni 14**

#### **Kërkesat për auditorët e jashtëm gjatë auditimit të llogarive vjetore**

1. Auditorët e jashtëm do të kryejnë të gjitha auditimet e siguruesve në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA).
2. Gjatë auditimit të një siguruesi, ndërmjetësuesi të sigurimeve, trajtuesi të dëmeve dhe, Byrosë Kosovare të Sigurimit, nga auditorët e jashtëm kërkohet që të përqendrohen në vlerësimin e rrezikut të likuiditetit, rrezikut vetvetishëm, rrezikut të tregut, rrezikut operacional, dhe rreziqeve tjera, ndaj të cilave siguruesi ekspozohet, si dhe të shprehin opinionin e tyre në raportin e auditimit. Auditorët e jashtëm duhet të sigurojnë dhe të raportojnë se siguruesit kanë rregulluar menaxhimin e kënaqshëm të aseteve dhe se kontrollet e duhura janë në vend.

### **Neni 15**

#### **Sigurimi i përgjegjësisë profesionale**

Auditorët e jashtëm duhet të sigurojnë policë të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, siç përcaktohet me Udhëzimin administrativ 2015/01 për licencimin e auditorëve ligjorë, të KKRF-së.

## **Neni 16**

### **Letra e Menaxhmentit**

1. Auditorët e jashtëm në pajtim me Ligjin për sigurimet dhe rregulloret përkatëse të BQK-së, në përfundim të procesit të auditimit duhet të përgatitin letrën për menaxhmentin e siguruesit, dhe një kopje për BQK-në. Letra e menaxhmentit duhet të përfshijë të gjitha konkluzionet që auditori i jashtëm mund të ketë arritur lidhur me aktivitetin dhe gjendjen financiare të siguruesit.
2. Në letrën e menaxhmentit, auditorët e jashtëm duhet të bëjnë një deklaratë të veçantë në lidhje me sistemin e kontrolleve të brendshme me qëllim të zbulimit të çështjeve materiale në strukturën e kontrolleve të brendshme. Deklarata në mënyrë të veçantë duhet të përfshijë vlerësimin e funksionit të auditimit të brendshëm të siguruesit.
3. Në letrën e menaxhmentit, auditori i jashtëm duhet të bëjë një deklaratë të veçantë nëse ata arrijnë në përfundimin se siguruesi është në pajtim me ligjet dhe rregulloret përkatëse të BQK-së, dhe nëse siguruesi është në përputhje me gjetjet dhe rekomandimet e fundit të BQK-së.

## **Neni 17**

### **Çështjet që duhet të përfshihen në letrën e angazhimit të auditorit të jashtëm**

1. Kërkesat dhe kushtet që do të përfshihen në letrën e angazhimit të auditorit të jashtëm të një siguruesi të licencuar nga BQK-ja duhet të jenë si në vijim:
  - a) Frekuenca e auditimeve-siguruesit e licencuar duhet të kenë raportet e tyre financiare të audituara për çdo vit, në përputhje me periudhën e tyre financiare / të kontabilitetit.
  - b) Emërimi i auditorit të jashtëm duhet të jetë me shkrim dhe duhet të jetë subjekt i miratimit nga BQK-ja.
  - c) Pavarësia e auditorit - auditori apo firma e tij nuk duhet të jetë palë e lidhur me siguruesin e licencuar.
  - d) Fushëveprimi i punës së auditorit:
    - i. Shqyrtimin i përshtatshmërisë së auditimit të brendshëm, procedurave dhe praktikave të kontrolleve të brendshme, identifikimi dhe evidentimi i mangësive dhe dhënia e rekomandimeve për zbatim.
    - ii. Të shprehin opinionet e tyre, nëse pasqyrat financiare paraqesin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të gjendjes financiare të aktivitetit të siguruesit të licencuar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.
    - iii. Shkalla e pajtueshmërisë rregullatore - raporti i auditimit duhet të shprehë opinionin e tij nëse siguruesi i licencuar është në përputhje me ligjet e sigurimit, rregulloret dhe rregullat e miratuara nga BQK-ja.
2. Auditori i jashtëm duhet t'i raportoj drejtpërsëdrejti BQK-së për çështjet e mëposhtme:
  - a) Një veprim mashtrues të kryer nga një punonjës i siguruesit të licencuar, për parregullsitë dhe mangësitë në administrimin e operacioneve që mund të pritet dhe mund të rezultojë në një humbje materiale të siguruesit të licencuar.
  - b) Nëse siguruesi i licencuar ka shkelur sistematikisht rregullat e sigurimeve apo këtë rregullore.
  - c) Nëse konkluzionet e raportit të auditimit janë injoruar ose padrejtdësisht janë ndikuar në mënyrë direkte apo indirekte nga menaxhmenti apo bordi i drejtorëve të siguruesit të licencuar.



3. Çështje të tjera që duhet të përfshihen në letrën e angazhimit të auditorëve të jashtëm përveç kërkesave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, janë si në vijim:
  - a) Letra angazhimit duhet të përmbajë nënshkrimin e auditorit që konfirmon pranimin e kushteve të saj.
  - b) Bordi i drejtorëve ka përgjegjësi të mbaj BQK-në të informuar për çështjet e biznesit të siguruesit të licencuar.
  - c) E drejta e auditorit për të komunikuar me BQK-në për çdo informacion apo opinion për ndonjë çështje për të cilën ai është i vetëdijshëm se është e rëndësishme për mbikëqyrjen e BQK-së.
  - d) Detyra e auditorit për të raportuar çështjet e rëndësishme materiale në BQK.
  - e) Detyra e auditorit për të siguruar qasje në letrat e tij të punës për qëllime rregullatore me kërkesën e BQK-së.

### **Neni 18**

#### **Obligimi për të informuar**

1. Auditori i jashtëm duhet të ofrojë informata në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me siguruesin, të cilat i ka identifikuar gjatë kohës së auditimit kur kjo kërkohet nga mbledhja e përgjithshme e aksionarëve, bordi i drejtorëve, menaxhmenti i lartë, komiteti i auditimit apo nga një person i autorizuar nga BQK-ja.
2. Auditori i jashtëm duhet menjëherë t'i komunikojë komitetit të auditimit apo bordit të drejtorëve të siguruesit, ndonjë çështje me interes për qeverisje të cilën e ka vërejtur gjatë kryerjes së auditimit. Auditori i jashtëm, duhet menjëherë të njoftojë organet drejtuese të siguruesit dhe BQK-në, në rastet kur gjatë kryerjes së auditimit të siguruesit ai vëren:
  - a) Informatën që shfaq shenja të dështimit në përmbushjen e kërkesave nga licenca e dhënë nga BQK-ja;
  - b) Një konflikt serioz brenda organeve vendimmarrëse apo largimin e papritur të menaxherit që ka pasur funksion kyç;
  - c) Informatën e cila tregon se mund të ketë shkelje materiale të ligjeve, rregulloreve, udhëzimeve dhe urdhrave të BQK-së si dhe statutit dhe të akteve nënligjore të siguruesit; ose
  - d) Synimin e auditorit të brendshëm për të dhënë dorëheqje apo largimin e tij dhe ndryshimet negative apo materiale që paraqesin rrezik për punën e siguruesit dhe mundësinë që rreziku të vazhdojë.
3. BQK-ja mban kontakte të rregullta dhe mund të iniciojë takime me auditorin e jashtëm të siguruesit në çdo kohë kur kontaktet e tilla konsiderohen të nevojshme.

### **Neni 19**

#### **Kontrolli i cilësisë dhe rishikimi i tij**

1. Auditorët e jashtëm të aprovuar nga BQK-ja, mund të jenë subjekt i një rishikimi të cilësisë nga ana e BQK-së.
2. Auditorët e jashtëm të aprovuar nga BQK-ja duhet të aplikojnë politikat dhe procedurat adekuate të kontrollit të cilësisë të cilat i adresojnë të gjitha aspektet e rëndësishme të auditimit.

3. Rishikimi i cilësisë të një auditori të jashtëm të aprovuar, duhet të përfshijë një detyrë specifike të auditimit dhe duhet të kryhet nga ana e BQK-së apo nga ana e një rishikuesi të caktuar nga BQK-ja.
4. Gjatë rishikimit të cilësisë, BQK-ja apo rishikuesi duhet të përcaktojë se deri në çfarë mase auditori i jashtëm i ka aplikuar rregullat dhe procedurat adekuate të kontrollit të cilësisë, në të gjitha aspektet e rëndësishme të auditimit. Gjatë rishikimit, BQK-ja apo rishikuesi duhet të ketë qasje në të gjitha dokumentet e punës së auditorit të jashtëm deri në atë masë, që është e nevojshme për të kryer një kontroll adekuat të cilësisë.
5. Duke pasur parasysh obligimet për ruajtjen e konfidencialitetit, neni 11 i kësaj Rregulloreje aplikohet njëjtë si për BQK-në ashtu edhe për rishikuesin.
6. Rezultatet e përmbledhura të rishikimit të cilësisë do të publikohen nga BQK-ja, duke përfshirë rekomandimet, zbatimin e rekomandimeve dhe nëse ndodh ndonjë rast edhe sanksionet.

## **Neni 20**

### **Dokumentimi i kryerjes së detyrës**

Ashtu siç kërkohet me SNA “Dokumentimi i Auditimit”, auditorët e jashtëm duhet të dokumentojnë sesi është kryer një auditim si dhe rezultatet e një auditimi. Çështjet të cilat tregojnë se parregullsitë ose gabimet mund të jenë të pranishme duhet të dokumentohen në mënyrë të veçantë.

## **Neni 21**

### **Raporti i auditorëve të jashtëm**

1. Auditorët e jashtëm duhet të përgatisin një raport vjetor të auditimit me një opinion të auditimit në pajtim me SNRF në rast të paraqitjes së diferencave materiale, gjithashtu edhe një raport të auditimit me një opinion të auditimit në pajtim me Rregulloren e BQK-së mbi menaxhimin e rrezikut të siguresit.
2. Raporti i auditimit duhet të konfirmojë që shërbimet e auditimit janë kryer në pajtim me dispozitat e Ligjit për Sigurimet, kësaj Rregulloreje dhe rregulloreve të tjera relevante të BQK-së.
3. Raporti i auditimit duhet të verifikojë dhe shpalos çështjet në vijim:
  - a) Nëse llogaritë vjetore janë përgatitur dhe finalizuar në pajtim me SNRF, Ligjin për Sigurimet dhe rregulloret përkatëse të BQK-së dhe paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të gjendjes financiare dhe aktiviteteve të siguresit;
  - b) Nëse menaxhmenti i siguresit ka përmbushur obligimin e tij, për të siguruar shënime të sakta dhe të duhura si dhe dokumentimin e informatave kontabël; dhe
  - c) Nëse informatat në raportin vjetor në lidhje me llogaritë vjetore, supozimet lidhur me vazhdimësinë e operacioneve dhe propozimet në lidhje me shfrytëzimin e tepcive (fitimeve) apo mbulimin e humbjeve janë në pajtim me Ligjin për sigurimet dhe rregulloret përkatëse të BQK-së.

4. Nëse llogaritë nuk japin informata lidhur me rezultatin dhe gjendjen e siguruesit, auditorët e jashtëm duhet të theksojnë këtë ose të përcaktojnë opinionin dhe mundësisht të sigurojnë informata të nevojshme plotësuese në raportin e auditimit.
5. Nëse auditorët e jashtëm arrijnë në përfundim se llogaritë nuk duhet të përfundohen në formën e tyre aktuale, kjo duhet të theksohet në mënyrë të qartë.
6. Nëse auditorët e jashtëm, gjatë kryerjes së auditimit, zbulojnë rrethanat që mund të çojnë në përgjegjësi anëtarët e bordit të drejtorëve, asamblesë së përgjithshme të aksionarëve apo menaxhmentit të lartë, kjo duhet të paraqitet në raportin e auditimit. Auditorët e jashtëm, gjithashtu duhet të ofrojnë informata të tjera në lidhje me rrethanat për të cilat besojnë se duhet njoftuar pjesëmarrësit apo aksionarët e siguruesit.
7. Auditorët e jashtëm duhet të vlerësojnë zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i vitit paraprak financiar.
8. Auditorët e jashtëm, të cilët auditojnë llogaritë vjetore të kompanisë amë të siguruesit, duhet të përgatitin raport të veçantë të auditimit për grupin siç kërkohet me SNA. Dispozitat e paragrafit 1 deri 7 të këtij neni, aplikohen njëjtë në raportin e auditimit të grupit.

## **Neni 22**

### **Dorëzimi i raporteve të auditimit**

1. Siguruesit, ndërmjetësuesit e sigurimeve, trajtuesit e dëmeve dhe Byroja Kosovare Sigurimit, duhet të paraqesin në BQK pasqyrat vjetore financiare të audituara dhe letrën e menaxhmentit, jo më vonë se 30 prilli i vitit vijues për vitin paraprak.
2. Dega e siguruesit të jashtëm, përveç siç kërkohet në paragrafin e mësipërm, duhet të paraqesin në BQK pasqyrat e konsoliduara vjetore financiare të kompanisë mëmë së bashku me raportin e auditorit të jashtëm jo më vonë se 30 qershori i vitit vijues për vitin paraprak.

## **Neni 23**

### **Mirëmbajtja e letrave të punës së auditimit**

Letrat e punës së auditimit duhet të përgatiten dhe mirëmbahen në pajtim me SNA përkatës.

## **Neni 24**

### **Tarifat për shërbimet e auditimit**

1. Tarifat për shërbime të auditimit përmbajtësisht duhet të jenë objektive:
  - a) Të jenë adekuate që të mundësojnë kualitetin e duhur të auditimit;
  - b) Nuk duhet të jenë të influencuara apo të përcaktuara nga provizioni i shërbimeve shtesë të siguruesit që auditohet;
  - c) Nuk mund të bazohen në asnjë formë të kushtëzimit.

**Neni 25**  
**Ndryshimi i Auditorit të jashtëm**

1. Kur një sigurues, ndërmjetësues i sigurimeve, trajtues i dëmeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimit, synon të ndryshojë auditorin e saj të jashtëm, duhet të njoftojë BQK-në në formë të shkruar ku shpaloset arsyeja e ndërrimit të Auditorit të jashtëm.
2. Po ashtu edhe auditori i jashtëm duhet të njoftoj BQK-në në formë të shkruar mbi arsyet, përse është ndërruar auditori i jashtëm i entitetit për të cilin është aprovuar nga BQK-ja.

**Neni 26**  
**Shkarkimi, ndërprerja, dhe dorëheqja e auditorëve të jashtëm**

1. Auditorët e jashtëm të një siguruesi, ndërmjetësuesi të sigurimeve, trajtuesi të dëmeve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit, mund të shkarkohen vetëm nëse ka bazë të duhur për një veprim të tillë. Divergjenca e opinionëve të trajtimeve kontabël ose procedurat e auditimit nuk duhet të jenë bazë e mjaftueshme për shkarkim.
2. Si siguruesi, ndërmjetësuesi i sigurimeve, trajtuesi i dëmeve dhe Byroja Kosovare të Sigurimit, duhet ta informojë BQK-në në lidhje me shkarkimin, ndërprerjen apo dorëheqjen duke dhënë shpjegim të mjaftueshëm të arsyeve të tyre.
3. Për çdo emërim të ri të auditorit të jashtëm siguruesi, ndërmjetësuesi i sigurimeve, trajtuesi i dëmeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimit, duhet që të njoftoj BQK-në në afatin prej 15 ditësh nga dita e emërimit të ri.

**Neni 27**  
**Masat ndaj auditorit të jashtëm**

1. Nëse auditorët e jashtëm të siguruesit, ndërmjetësuesit të sigurimeve, trajtuesit të dëmeve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit, janë në kundërshtim me detyrat e auditorit, në pajtim me këtë Rregullore, Ligjin e sigurimeve dhe rregulloret e tjera relevante të BQK-së, përmes një shkresë BQK-ja mund ta paralajmëroj auditorin e jashtëm apo të lëshojë vërejtje me shkrim, varësisht nga shkalla e shkeljes.
2. Nëse auditorët e jashtëm të siguruesit, ndërmjetësuesit të sigurimeve, trajtuesit të dëmeve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit, kanë shkelur rëndë, ose në mënyrë të përsëritur detyrat e auditorit të jashtëm të parapara me këtë Rregullore, Ligjin e sigurimeve dhe rregulloret përkatëse të BQK-së, BQK-ja ka të drejtë të ndalojë një auditor të jashtëm nga auditimi i siguruesve, ndërmjetësuesve të sigurimeve, trajtuesve të dëmeve dhe Byrosë Kosovare të sigurimeve, për një periudhë deri në tre (3) vjet.

**Neni 28**  
**Tërheqja e aprovimit të auditorëve të jashtëm nga BQK-ja**

1. BQK-ja do të tërheqë aprovimin e auditorit të jashtëm të aprovuar në rastet kur:
  - a) BQK-ja ka konstatuar se aprovimi është fituar në bazë të të dhënave të rreme të qëllimshme;

- b) Auditori i jashtëm i aprovuar kryen një shkelje të rëndë të ligjeve, rregulloreve dhe rregullave të sigurimeve dhe ka bërë shkelje të profesionit të auditimit dhe kodit të etikës;
  - c) Auditori i jashtëm i aprovuar shkel dispozitat e çdo neni të kësaj rregulloreje, Ligjit të sigurimeve apo rregullave tjera të BQK-së;
  - d) BQK-ja ka përcaktuar se reputacioni i mirë i atij personi apo firme është kompromentuar seriozisht;
2. BQK-ja do të informojë siguruesin, ndërmjetësuesin e sigurimeve, trajtuesin e dëmeve dhe Byronë Kosovare të Sigurimit, për të cilin auditori i jashtëm i autorizuar kryen shërbime të auditimit, lidhur me tërheqjen e aprovimit të auditorit të jashtëm.

## **Neni 29**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 2 maj 2016. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, sa i përket siguruesve, ndërmjetësuesve të sigurimeve, trajtuesve të dëmeve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimeve, shfuqizohet çdo dispozitë e instrumenteve rregullatore të BQK-së, që është në kundërshtim me këtë Rregullore.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

---

Prof. Dr. Bedri Peci